



**Shoqata e të Verbërve të Kosovës**  
**Kosova Association of the Blind**  
**Udruzenje Slepih Kosova**

# Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

**Nr. 18**



**Funded by  
the European Union**

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Gusht, 2023

# Përmbajtja

<i>Dy fjalë për botimin.....</i>	<i>faqe 3</i>
<i>Intervista e numrit: Daut Tishuki, kryetar i Shoqatës së të verbërve të Kosovës.....</i>	<i>faqe 4</i>
<i>Gjykata kushtetuese vendos interpreton ndryshimin e kushtetutës së Kosovës.....</i>	<i>faqe 8</i>
<i>Përkujtim: Mexhid Foniqi (1957-2023).....</i>	<i>faqe 11</i>
<i>Kronika: Aktivitetet e shoqatës së të verbërve të Kosovës korrik-qershor 2023.....</i>	<i>faqe 13</i>
<i>QBMK, një vit drejt përmirësimit të shërbimeve dhe cilësisë në arsimin .....</i>	<i>faqe 15</i>
<i>Program i kandidaturës për kryetar të SHVK.....</i>	<i>faqe 19</i>

## Këshilli botues:

Enver Ulaj, Kryeredaktor;

Melihate Pllana, Bekim Krasniqi Florian Tishuki, përgatitja e artikujve.

## *Dy fjalë për botimin*

Të dashur lexues të revistës “Syri ynë”.

Pas dy muajve po botojmë edhe një numër tjetër të revistës sonë periodike. Është një kohë e shkurtër për të sjellë ndonjë ndryshim të madh tek lexuesit tonë, por një kohë e mjaftueshme për të parë ndryshime dhe angazhime serioze që

Synojnë përmirësimin e gjendjes për komunitetin e personave të verbër në Kosovë. Ndodhin njëkohësisht dhe janë tri çështje të rëndësishme që kanë bëjnë me interesimin e personave të verbër dhe me një angazhim të madh që e ka bërë na vazhdimësi Shoqata e të verbërve të Kosovës dhe ka përqendruar lobimin dhe avokim të fuqishëm në këtë drejtim. E para është më në fund hapja e tenderit të Ministrisë së arsimit, shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit për sintezën vokale në gjuhën shqipe. Kjo e con në fazë fundit objektivin strategjik shumë vjeçar të Shoqatës dhe akterëve tjerë që pas vitit kushtuar personave me aftësi të kufizuara, kulmon me hapjen e tenderit nga i cili pritet angazhimi i profesionistëve që do e përfundojnë këtë proces me buxhetin e siguruar nga Qeveria e Kosovës.

E dyta është hartimit të planit Strategjikë Qeveritar për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2024-2027. SHVK është pjesë e angazhimit konstruktiv në këtë plan dhe pret që dokumenti të adresojë çështjet që ka komuniteti në periudhën katër vjeçare në vazhdim. E treta është hartimi Draft - Rregullores për Funksonimin e Komisionit Mediko-Social dhe Procedurat e Aplikimit për Realizimin e të Drejtave për Personat e Verbër. SHVK ka këmbëngulur dhe ka përfshirë në draft kërkesat e veta për lehtësira për personat e verbër.

Ajo që njëkohësisht ndodhe në këtë kohë poashtu është përmbyllja e procesit zgjedhor në shoqata komunale dhe ndërkomunale dhe mbajtja e kuvendit qendror. Shoqata ka bërë thirrjen publike për kandidaturat për kryetar dhe në muajin shtator do të përmbyllet i gjithë procesi me kuvendin qendror dhe zgjedhjen e kryetarit dhe kryesisë.

Fatkeqësisht në këtë kuvend, anëtarësia nuk do ketë me vetë aktivistin dhe ish kryetarin e degës së Prishtinës Mexhid Foniqi, që ndërro jetë gjatë muajit gusht.

Shoqata e të verbërve të Kosovës në muajt në vazhdim angazhohet në aktivitete e saj të rregullta në fuqizimin dhe mbrojtjen e personave të verbër dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për ta në Kosovë.

Këshilli botues i revistës “Syri Ynë”

## *Intervista e numrit:*

### *Daut Tishuki, kryetar i Shoqatës së të verbërve të Kosovës*

Viti 2023 është vit jubilar për Shoqatën e të verbërve të Kosovës në 20 vjetorin e ri regjistrimit të saj. Ndonëse shoqata është vijuese e Lidhjes së të verbërve të Kosovës, ri regjistrimi i saj pas luftës bazuar me legjislacionin e ri kosovar është bërë në vjeshtën e vitit 2003. Për aktivitete e shoqatës dhe angazhimin e saj këtë periudhë flet kryetari i saj Daut Tishuki. Ai ka diskutuar për çështjet më aktuale, rrjedhat që po ndodhin në Kosovë dhe riorganizimin e shoqatës.

*Pyetje 1. Jeni kryetar i shoqatës prej 3 vjetësh, si është zhvilluar shoqata dhe sa ka arritur të plotësojë kërkesat e komunitetit në këtë periudhën?*

Unë kam marr mandatin në qershor të viti 2018, Kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, i pasuar me Këshillin Drejtues i përberë nga: Daut Tishuki- kryesues nënkryetari Daut Hoxha, nënkryetar i dytë Driton Obërtinca anëtar Agim Halimi, Felona Bajrami dhe Urim Kabashi. Trajnerët kanë qenë 36 të cilët kanë qenë pjesë e ofrimit të trajnimeve nga degët e Shoqatës të cilat janë të shtrira nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës, dhe stafi i cili ka qenë i përberë nga Bekim Krasniqi, Emine Prekaj Kuqi Melihate Pllana, Hajrie Xhemali, si dhe herë pas herë të kontraktuar përmes projekteve ekspert e fasilitues.

Fillimisht, se bashku me Këshillin Drejtues dhe Stafin kemi angazhuar një kompani për hartimin e Planit Strategjik të shoqatës për 5 vitet e ardhshme, si dhe trajnime për hartimin e planit strategjikë. Kjo ka qenë nisma e parë si kryetar i SHVK-së pasi që përpilimi i objektivave për mua është edhe udhërrëfyesi më i mirë për ecurinë e punës time si kryetar.

Pas hartimit të strategjisë, kemi hartuar rregullore, programe por edhe plane veprimi, hulumtime udhëzues me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të shoqatës për përmirësimin e situatës së personave të verbër dhe me dëmtime në të parë, e që është edhe mision i shoqatës sonë.

Gjatë këtyre viteve kemi hartuar këto rregullore: Rregulloren e Burimeve Njerëzore, Rregulloren e Punës së anëtarëve të Kuvendit, Rregulloren për Zgjedhjet e shoqatës, Rregullore për Barazi Gjinore, Rregullore Financiare dhe Prokurimin, programi për mentorim social, Programi për hartimin dhe zhvillimin e projekteve, Hulumtime për të drejtat në punësim të personave të verbër por edhe udhëzues për edukimin e stafit të institucioneve parashkollore, udhëzuesi për akomodimin e nxënësve dhe studentëve të verbër në arsim.

Kjo ka qenë sa i përket ngritjes së kapaciteteve organizative të shoqatës, ndërsa punëtori dhe takime të ndryshme të cilat kanë pas për qëllim marrjen e njohurive të reja rreth realizimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe në veçanti për personat e verbër.

Avokimi kryesisht si kryetar i Shoqatës ka qenë i fokusuar rreth zbatueshmërisë së Ligjit për personat e verbër, ligji për aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, dhe ligjeve të tjera ekzistuese që prekin jetën e personave të verbër.

*Pyetje 2: Cilat janë arritjet kryesore deri më tani?*

Përkushtimi dhe angazhimi im si kryetar por edhe mund të themi i përbashkët me stafin, këshillin drejtues dhe të gjitha degët e shoqatës, mund të selektojmë disa të arritura. Arritje kryesore është se në vitin 2019 me përkrahjen e Ministrisë së Inovacionit të asaj kohe dhe me bashkëpunim me Ministrin e Arsimit kemi arrit të bëjmë unifikimi i Brailit Shqip dhe avancimi sipas standardeve ndërkombëtare që do t'a lehtësoj përdorimin e teknologjisë informative për personat e verbër në Republikën e Kosovës. E më pas ky unifikim u fuqizua edhe më shumë me vendim të Ministrit të Arsimit. Në vazhden e punës dhe angazhimit tonë kemi ofruar trajnime për komunitetin e të verbërve në shkrim lexim në brail, orientim e mobilitet, teknologji asistuese për të verbër dhe shërbime këshilla psiko sociale për komunitetin e të verbër në përgjithësi si dhe trajnim i trajnerëve për përdorimin e teknikave dhe metodave të avancuara për ofrim të shërbimeve sa më cilësore.

Gjithashtu, siç e thash më lartë edhe ngritja e kapaciteteve përmes hartimit të rregulloreve, mbajtjen e trajnimeve dhe zhvillimin e programeve të ndryshme ka bërë që SHVK të ngrit kapacitete organizative dhe profesionale.

Një nga të arriturat është edhe punësimi i personave të verbër, ku gjatë kësaj periudhe janë punësuar disa person të verbër dhe me dëmtime në të parë përmes formave të ndryshme. Nuk është numri i kënaqshëm por të paktën ka nisma të mira.

Rezultat i kënaqshëm është se falë punës shumë vjeçare dhe angazhimit të përbashkët Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacioni përmes një kompanie ka hartuar termat e referencës fillimisht për të hapur rrugë tenderimit për zhvillimin e sintezës voakle. Ndërsa në muajin gushtë është dal edhe tenderi i cili ka hap rrugë drejt realizimit të kësaj nisme e kahershme e shoqatës së të Verbërve të Kosovës. Shoqata ka qenë pjesë e hartimit të termave të referencës dhe në koordinim me MASHTI-in po e përcjellim hapat e mëtutjeshëm

Rezultat është se Ministria e Financave Punës dhe Trasnfereve, ka krijuar një grup punues për plotësim ndryshimin e Rregullores së Komisionit Mediko Social për shqyrtimin e mundësive që përfituesit e grupit të parë mos të ju behet vlerësimi çdo 5 vite.

*Pyetje 3: Cilat janë vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballët shoqata në funksionimin e saj dhe për të arritur misionin e saj?*

Mungesa e fondeve dhe mungesa e financimit të përhershme që ju nevojitet personave të verbër për ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme, koha e pandemisë COVID-19, ka qenë sfidë për të gjithë por edhe për personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi, mungesa e mjeteve ndihmëse dhe materiali në brail për arsimin universitar dhe krijimi i qendrës rehabilituese për personat e verbër.

*Pyetje 4: Sa ka qenë mbështetja për shoqatën në këtë periudhë ?*

Me hartimin e projekteve kemi has në mirëkuptim nga donatorët e ndryshëm dhe mbështetja ka qenë e kënaqshme duke përkrahur shoqatën për të realizuar objektivat dhe misionin e saj.

*Pyetje 5: Cila është gjendja e dialogut social me Qeverinë, sa ka arritur të avokojë SHVK lidhur me të drejtat e komunitetit të personave të verbër?*

Shoqata ka pas bashkëpunim të mirëfillt mund të themi me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, duke filluar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, saktësisht me drejtorin e kësaj zyre z. Habit Hajredini, me zyrtarët nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Financave Puësn dhe Transfereve, me komisionet parlamentare, me Insektoriatin e Punës, deputet por edhe zyrtar nga institucionet e ndryshme, të cilat kanë kontribuar në aktivitete e orga nizuara nga SHVK por edhe duke marr përgjegjësit insitucionale për atë sa ka qenë e mundur për të gjetur hapat konkret për të gjetë zbatueshmërin e ligjeve ekzistuese që prekun jetën e personave të verbër.

*Pyetje 6: Sa është i angazhuar vetë komuniteti, sa arrin të kontribuojnë në arritjen e synimeve që ka shoqata?*

SHVK përmes përkrahjeve nga donatorët e ndryshëm është përpjekë të rritë kapacitetet e saj dhe falë kësaj vërehet një vetëdijësim i komuniteti në këtë drejtim.

*Pyetje 7: Ky vit është një vit zgjedhor për SHVK-në dhe degët e saj komunale dhe ndërkomunale, si po shkon ky proces dhe cilat janë risitë?*

Shoqata fillimisht me vendim të Këshillit Drejtues ka hap zgjedhjet lokale të SHVK-se dhe ka përcaktuar komisionin zgjedhor i përberë nga kryesuesi dhe dy anëtarë.

Zgjedhjet lokale kanë përfunduar dhe si proces ka shkuar mirë në përgjithësi, ku secila degë në mënyrë demokratike dhe duke u bazuar në Rregulloren për Zgjedhjet e SHVK-se kanë zgjedhë organet e tyre udhëheqëse dhe legjitime për 5 vitet e ardhshme. Tani kemi zgjedhjet nacionale të cilat do të mbahen me 9 shtator 2023, në Qendrën për Mësim dhe Këshillim Xheladin Deda në Pejë. Thirrja për aplikim për kryetar të SHVK-se ka qenë e hapur përmes rrjeteve sociale për aplikim.

*Pyetje 8: Cilat mbesin detyrat kryesore në vitin në vazhdim?*

Pas zhvillimit të Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, SHVK do të angazhohet për mbajtjen e trajnimeve që produktin personat e verbër ta gëzojnë dhe ta përdorin për nevojat e tyre në teknologjinë informative asistuese për të verbër.

Avokim dhe lobim për ngritjen e fondeve

Do të angazhohemi për avokim dhe lobim duke bërë presion institucioneve nacionale dhe lokale për zbatimin e Ligjit për të Verbërve dhe ligjeve ekzistuese për përmirësimin e jetës së personave të verbër. Ndërsa, në veçanti do të avokojmë për zbatimin e nënti 12 të ligjit të verbër për krijimin e qendrave rehabilituese për personat e verbër

## *Gjykata kushtetuese vendos për kërkesën për të interpretuar ndryshimin e kushtetutës së Kosovës*

Gjykata kushtetuese vendos për kërkesën për të interpretuar ndryshimin e kushtetutës së Kosovës me qëllim që në të të përfshihet Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Interpretimi i Gjykatës i hap rrugë procedurës për këtë ndryshim të nevojshëm të kushtetutës, për çka Shoqata e të verbërve është angazhuar në vazhdimësi dhe ka lobuar tek institucionet vendimmarrëse

Në vazhdim po paraqesim vendimin e plotë të Gjykatës kushtetuese të Kosovës.

Njoftim për vendim në rastin KO 207/22

01.08.2023

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesën në rastin KO 207/22, parashtruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të amendamentit të propozuar kushtetues. Kërkesa është parashtruar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe është dorëzuar në Gjykatë, më 21 dhjetor 2022, bazuar në paragrafin 9 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sipas të cilit, Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara për vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar kushtetues i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.

Gjykata, njëzëri ka vendosur që të (i) deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë që (ii) amendamenti i propozuar i nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, përmes të cilit, listës së marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës i shtohet edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nuk pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.

Përkritazi me vlerësimin e amendamentit kushtetues të propozuar nga Kuvendi, Gjykata fillimisht analizoi parimet kryesore të përcaktuara me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe vuri theks në të drejtat që ajo përcakton lidhur me (i) respektin për dinjitetin e natyrshëm, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale dhe pavarësinë e personit me aftësi të kufizuara; (ii) respektimin e parimit të mosdiskriminimit; (iii) pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri; (iv) respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; (v) respektin për kapacitetet në



zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; si dhe (vi) respektin për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Gjykata gjithashtu vuri theks në detyrimet pozitive që merr përsipër Republika e Kosovës përmes këtij amendamenti kushtetues, duke pasur parasysh që Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton edhe detyrime specifike pozitive ndaj shteteve, ndër tjerash, për ndërmarrjen e (i) masave të nevojshme legjislative; si dhe (ii) masave të tjera, duke krijuar mekanizma në funksion të zbatimit të plotë të Konventës në fjalë.

Vërejtje:

Ky njoftim për media është përgatitur nga Sekretariati i Gjykatës vetëm për çështje informative. Teksti i plotë i vendimit do t'u dorëzohet palëve të përfshira në rast, do të publikohet në ueb-faqen e Gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare, pasi të jenë përfunduar procedurat përkatëse të përcaktuara në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e saj të punës. Përmbledhja e publikuar përmes këtij Njoftimi mund t'i nënshtrohet korrigjimeve gjuhësore dhe teknike në draftin final të vendimit.

[https://gjk-ks.org/decision/vleresimi-i-amendamentit-te-propozuar-te-kushtetutes-se-republikes-se-kosoves-te-propozuar-nga-qeveria-e-republikes-se-kosoves-dhe-te-dorezuar-nga-kryetari-i-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-m/?decision\\_vieë=text](https://gjk-ks.org/decision/vleresimi-i-amendamentit-te-propozuar-te-kushtetutes-se-republikes-se-kosoves-te-propozuar-nga-qeveria-e-republikes-se-kosoves-dhe-te-dorezuar-nga-kryetari-i-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-m/?decision_vieë=text)

**KO207/22, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i amendamentit të propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 dhjetor 2022, me shkresën nr. 08/3198/DO-1347/1**

KO207/22, Aktgjykim i 4 korrikut 2023, publikuar më 7 gusht 2023

Fjalët kyçe: *Amendamente kushtetuese, kontroll preventiv i kushtetutshmërisë, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur dhe publikuar Aktgjykimin në rastin **KO207/22**, me parashtrues Kuvendi i Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e amendamentit të propozuar kushtetues të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 21 dhjetor 2022. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 9 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sipas të cilit, Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

Gjykata, njëzëri vendosi që kërkesa është e pranueshme dhe konstatoi që amendamenti i propozuar i nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, përmes të cilit, listës së marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

drejtpërdrejtë të aplikueshme i shtohet edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nuk zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

Përkitazi me vlerësimin e amendamentit të propozuara nga Kuvendi, Gjykata fillimisht analizoi parimet kryesore të vendosura me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe vuri theks në të drejtat që ajo përcakton përkitazi me (i) respektin për dinjitetin e natyrshëm, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit me aftësi të kufizuara; (ii) respektimin e parimit të mosdiskriminimit; (iii) pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive të tyre në shoqëri; (iv) respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; si dhe (v) respektin për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respektin për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre. Gjykata gjithashtu vuri theks në detyrimet pozitive që merr përsipër Republika e Kosovës përmes këtij amendamenti kushtetues, duke pasur parasysh që Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton edhe detyrime specifike pozitive ndaj shteteve për ndërmarrjen masave të nevojshme legislative, si dhe masave të tjera, duke krijuar mekanizma në funksion të zbatimit të plotë të saj.

Bazuar në të lartcekurat dhe pasi që i vlerësoi të njëjtat nën dritën e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, Gjykata konstatoi që teksti i amendamentit të propozuar nuk zvogëlon asnjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II.

Parashtruesit: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lloji i kërkesës: KO - Kërkesë nga organet shtetërore

Lloji i aktit: Aktgjykim. Mosshkelje e të drejtave kushtetuese

Lloji i procedurës së ndjekur para institucioneve tjera : Tjetër

## *Përkujtim: Mexhid Foniqi (1957-2023)*

Këtë muaj u nda na ne aktivisti shumë vejar i Shoqatës së të verbërvë Mexhid Foniqi, një mik e bashkëpunor i dalluar që pati detyra me rëndësi në akudër të shoqatës. SHVK familjes Foniqi në emrin e të gjithë anëtarëve të saj, u ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes për humbjen e të dashurit të tyre, e poashtu edhe kolegë, bashkëpunëtorëve si dhe të gjithë atyre që e kanë njohur aktivistin e punëtorin Mexhid Foniqi.

Mexhid Foniqi u lind në Malishevë Komuna e Gjilanit, në vitin 1957, Shkollën fillore e përfundojë në fsh. Doberçan, shkollimin e mesëm Gjinnazi shoqëror në Gjilan drejtimin gjuhësor. Pas shkollimit të mesëm ka përfunduar fakultetin e Filozofik në degën Filozofi-sociologji në Universitetin e Prishtinës, dhe mori titullin Sociolog. Pas përfundimit të studimeve, Mexhidi është punësuar në bibliotekën e qytetit të Gjilanit në degën Dobërçan, ku ka qenë iniciues i hapjes të kësaj biblioteke.

Që nga viti 1984 ka qenë sekretar në Lidhjen Nderkomunale e të Verbërve në Prishtinë, Anëtarë I rregullt i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës e punëtor deri në vitin 2022 kur u pensionua. Që nga viti 2004 është në organet udhëheqëse të Shoqatës, ka implementura projekte të shumta në kuadër të shoqatës me theks të veçantë në fushën e avokimit. Gjatë e ka mbajtur pozitën e Drejtorit Ekzekutiv në shoqatë.

Ka marr pjesë në disa vizita ndërkombëtare të organizuara nga EDIEF. Ka mbajtur ligjërata për punëtorët e Qendrave për Punë Sociale, me temën mos diskriminimi. Pjesëmarrës në takime të ndryshme të komitetit ballkanik të të verbërve, pjesëmarrës në hartimin e ligjeve për aftësinë e kufizuar e me theks të veçantë në Ligjin për personat e verbër e së fundmi ka qenë pjesë aktive e draft ligjit gjithëpërfshirës.

Gjatë udhëtimit të tij, pati shumë vështirësi nga një sëmundje e pa shërueshme e syrit u verbërua, dhe në atë kohë ishte në vitin e parë të studimeve. Mirëpo, falë përkushtimit të tij dhe me ndihmën e bashkëshortes dhe familjarëve arriti të përfundoj studimet.

Pikëllimi për ne e sidomos për familjen Foniqi është i madhe, por krenaria është edhe më e madhe për kontributin që dha për komunitetin e të verbërve por edhe në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara

Ishte bashkëpunëtor, i urtë dhe I dijshtëm, shkëmbimin e përvojave e pranonte nga secili, kjo e bënte edhe më të dalluar. Kush e njohu dhe bashkëpunoj me Mexhitin, ishin të kënaqur dhe mbresëlënëses për qetësin, besimin dhe profesionalizmin e tij.

Familjar të nderuar të familjes Foniqi, kolegë, dhe ju bashkëvendës të pranishëm edhe një here pranoni ngushëllimet e sinqerta për humbjen e babait, kolegut, mikut dhe bashkëpunëtorit tone,

jemi të bindur se do ta kujtojmë vetëm për veprat e mira që la pas vetes, prandaj rrini krenarë që e patët udhërrëfyes të punës dhe jetës.

Mexhiti ka lënë pas vetes bashkëshorten Semren Dajlin Gazmendin, Vajzen Valentinën, nipin dhe mbesën

I qoftë i lehtë dheu e Zoti e mëshiroftë me të mirat e tij.

Edhe Forumi Kosovar i aftësisë së Kufizuar ka dërguar telegram ngushëllimi

Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të Mexhit Funiqit, kolegut, bashkëpunëtorit, mikut tonë i cili ishte lokomotiva e Shoqatës të Verbërve të Kosovës për shumë vite.

Mexhiti për një kohë të gjatë e udhëhoqi Shoqatën e të verbërve me përkushtimin më të madh, dhe dijen e tij vuri në shërbim të shoqatës dhe të verbërve duke fituar mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare - ambasadave në ngritjen dhe zhvillimin e shoqatës dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Fal mundit e dijës së tij, të verbrit e Kosovës gëzojnë gjendjen juridike dhe faktike më të mirë se ata në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Me angazhimin e pasqor të Mexhitit nxënësit e studentët e verbër punojnë me teknologji që u ka mundësuar shkollimin deri në studime pasuniversitare. Angazhimi i tij ka mundësuar që disa të verbër të bëhen këngëtarë shumë të njohur, gazetarë të vlerësuar, juristë, ekonomistë, ekspert të teknologjisë informative e të tjerë.

Kontributi i mikut tonë Mexhit Funiqit mbetet një nga më të vlefshmit për personat me aftësi të kufizuara.

Me këtë rast, Kryesia e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjen, miqtë, bashkëpunëtorët dhe të gjithë ata që e kanë njohur dhe dashur Mexhitin.

## ***Kronika: Aktivitetet e shoqatës së të verbërve të Kosovës në periudhën Korrik -Gusht 2023***

### **Kërkimi i mundësive për hapësira të reja për SHVK-në**

9 gusht 2023- Menaxheri i programeve të SHVK-se z. Bekim Krasniqi, ka zhvilluar një takim pune me kryeshefin e ndërmarrjes publike banesore z. Arton Berisha.

Qëllimi i takimit ishte gjetja e mundësive për hapësira të reja për SHVK-në, për të ushtruar veprimtarin e saj në ambiente të përshtatshme, pasi që SHVK aty ku vepron janë hapësira të vogla.

### **MASHTI ka hapur tenderin për zhvillimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe**

5 gusht 2023- Edhe një hap më afër realizimit të një prej objektivave strategjike të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës! Pas shumë vitesh lobimi, MASHTI ka hapur tenderin për zhvillimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe, si dhe përkthimin e softuer-it që flet në gjuhën shqipe.

Po ashtu, do t'i furnizojë të verbrit me licencat e këtyre produkteve, të cilat do të krijojnë mundësi të barabartë për të përdorur në mënyrë të pavarur teknologjinë ndihmëse për të gjithë personat e verbër.

SHVK pas një angazhimi më se një dekade në këtë çështje falënderon të gjithë partnerët që na mbështeten dhe kontribuuan drejt realizimit të këtij objekti strategjik të SHVK-së.

### **Shoqatës së të Verbërve të Kosovës shpall thirrjen për paraqitjen e kandidaturave për kryetar**

04 korrik 2023- Duke u bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (SHVK), që Kuvendi Zgjedhor i Kuvendit të Anëtarëve të të Verbërve të Kosovës, do të mbahet me 9 shtator 2023, SHVK në bazë të Rregullores për Punën e Kuvendit të Anëtarëve të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, saktësisht në bazë të nënti Neni 12- Zgjedhja e Kryetarit, Shpall thirrjen për paraqitjen e kandidaturave për kryetar të SHVK-së.

### **Universiteti i Prishtinës ka hapur thirrjen për aplikim për mbështetje financiare**

11 korrik 2023- Universiteti i Prishtinës, ka hapur thirrje për të gjithë studentët me aftësi të kufizuara për mbështetje financiare

SHVK ka shpërndarë linkut me detajet e aplikimit për të qenë përfitues i kësaj mbështetje.

Universiteti i Prishtinës ka hapur thirrjen për aplikim për mbështetje financiare për studentët, të cilët i përkasin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Mbështetja do të jetë në lartësi deri në 450,00 euro, varësisht numrit të përfituesve dhe buxhetit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

### **Hartimi i Draft - Rregullores për Funkionimin e Komisionit Mediko-Social**

18-20 Gusht 2023- U mbajt punëtorja për hartimin e Draft - Rregullores për Funksionimin e Komisionit Mediko-Social dhe Procedurat e Aplikimit për Realizimin e të Drejtave për Personat e Verbër. Punëtorja është mbajtur në Prevallë në Hotel “Abi Green”. Me ftesë të këshilltarit të Ministrit të sekretari të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve., kryetari i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës ka marr pjesë në këtë punëtori e cila ka për qëllim draftimin e Rregullores për Funksionimin e Komisionit mediko-social dhe procedurat e aplikimit për realizimin e të drejtave të personave të verbër.

### **Mbledhje Komemorative për kolegun dhe aktivitetin e SHVK Mexhit Foniqi**

18-19 gusht 2023 – është mbajtur një mbledhje Komemorative për kolegun dhe aktivitetin shumë vjeçar të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës Mexhit Foniqi, i cili ka ndërruar jetë. SHVK ka pranuar ngushëllime nga shumë bashkëpunëtor, organizata por edhe nga vet komuniteti i të verbërve të Kosovës dhe më gjerë.

### **Plani strategjik dhe plani i veprimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2024-2027 për persona me aftësi të kufizuara**

Korrik-Gusht 2023 – Kanë filluar dhe për një kohë do të vazhdojnë takimet me Qeverinë saktësisht me Zyrën për qeverisje të mire, organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, dhe akterë të tjerë relevant me qëllim të hartimit të planit Strategjik Qeveritar për personat me aftësi të kufizuar pasi 2024-2027. Qëllimi i hartimit të këtij plani është që secila shoqatë të jap kontributin e saj në këto takime, në mënyrë që ky plan të jetë sa më i zbatueshëm dhe mos të ketë vështirësi gjatë implementimit.

## *Shkolla për të verbër, një vit drejt përmirësimit të shërbimeve dhe cilësisë në arsimin e personave të verbër*

Qendra burimore për mësim dhe këshillim ka përmbyllur në muajin gusht një vit shkollor 2022-2023 të vështirë që filloi me grevat në arsim, me pasojat e pandemisë, por që brenda 10 muajve shënoi shumë arritje, pjesëmarrja dhe promovim të personave të verbër. Viti i ri shkollor që po fillon në muajin shtator 2023 shkolën e gjen me plot plane dhe aktivitete të angazhuara por edhe në përballje me sfida të reja dhe të vjetra.

### **Ngritja dhe zhvillimi profesional i stafit, fuqizimi i shërbimeve mbështetëse në terren**

Stafi i QB ka marrë pjesë në këto trajnime: trajnimi për terapi muzikore nga ekspertja zvicerane e terapisë muzikore Regina Stainer organizuar nga Ministria e Arsimit Divizioni i arsimit special;

Trajnimi për punë në qendër burimore dhe edukimin inkluziv “Aftësia e kufizuar dhe arsimi gjithëpërfshirës”, projekti INCLUDE (dy herësh në dy grupe) në periudhën shtator- korrik dhe trajnim nga KCSF për diversifikimin dhe ngritjen e fondeve

Nga stafi i shkollës janë përgatitur dhe mbajtur dy trajnimet me mësimdhënës të shkollave të Pejës, katër trajnimet me mësimdhënës të shkollave të Prishtinës dhe tri trajnime në shkollat e Prizrenit, financuar nga Instituti Ed Guard për identifikimin dhe referimin e rasteve të nxënësve me dëmtime në shikim në shkolla.

Janë mbajtur ligjëratat me drejtorët e shkollave në Deçan në kuadër të javës së diversitetit MASHTI, një trajnim për ekipin e asistentëve në Preshevë, Drejtoria për inkluzion, shtatë trajnime për inspektorët e punës nga të shtatë rajonet e Kosovës për zbatimin e legjislacionit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përfaqësues nga QB kanë marrë pjesë me një Prezantim në punëtorinë me grupin punues për ndryshimin e ligjit për te drejtat e autorit në mënyrë që në draftin e ligji të përfshihet edhe obligimet e Traktit të Marakeshit mbi detyrimin që personave të verbër t'u krijohet mundësi që të kenë qasje në materialet e shkruara të printuara. Një përfaqësues i QB ka qenë pjesëmarrje në punën e grupit punues Rishikimi i programit në fusha të aktiviteteve nga MASHTI

Mësimdhënës dhe nxënës të shkollave kanë marrë pjesë në punëtorinë “Arti nëpër shkolla” nga MKRS, në aktivitetet sportive, Drejt Malit nga MKTS për skijim, në konferencën

kushtuar Lui Braj në Prishtinë organizuar nga SHVK, përcjellja e konferencës “Arsimi gjithëpërfshirës nga politika në Praktikë, Këshilli i Evropës, Ekspozita e nxënësve në shkollë gjatë Javës së Diversitetit, Pjesëmarrje në tryezën e MASHTI dhe ekspozitën shoqërore me punime të

nxënësve. Tryeza “Diversiteti në Shkolla-Tri Dimensionet e Gjithëpërfshirjes” organizuar nga MASHTI dhe në përgjithësi shënimi ditëve kush kushtuar personave me aftësi të kufizuara

### **Bashkëpunimi, partneritetet dhe implementimi i projekteve**

Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe gjatë vitoit ka vazhduar si zakonisht me Shoqatën e të verbërve të Kosovë për ngritjen e stasit dhe rpezantimine personave të verbër. SHVK ka përfshirë nxënësit në kampingu pesëditor i mbështetur nga UNMIK-u për nxënësit e QBMK “Xheladin Deda”; Një punëtori kushtuar krijimtarisë artistike të personat e verbër në Durrës, pjesëmarrje në trajnim e shkathtësive për jetë mbajtur në Rugovë, përfshirja e fëmijëve të shkolës në krijimin dhe publikimin e poezive dhe tregimeve në një libër publikim kushtuar personave të verbër, me financim nga Ministria e Kulturës, rinisë dhe sportit “Pak Dritë”, i cili edhe është përpuruar në Prishtinë.

Mbështetje për SHVK për aplikim tek donatorët Ambasada Çeke apo projekte tjera te Ambasada holandeze, USAID, UNMIK, UNDEF për shkollimin e mesëm dhe lartë të personave të verbër në Kosovë, projektet për sigurinë në shkollë dhe rrugë, një hulumtim mbi personat e verbër të punësuar, për qasjen në drejtësi, Jubileu dhe muaji kushtuar shkopit te bardhe, Aftësimet profesionale, etj.

Trajnimi në shkollë nga SHVK për Orientimin dhe mobilitetin për komunitetin

Bashkë me SHVK kemi qenë pjesë e grupit që ka koordinuar me Zyrën për të Drejtat e Autorit lidhur me detyrimet që dalin nga Trakti i Marakeshit në ligjin e ri për të drejtat e autorit (që është miratuar gjatë muajit dhjetor) në Kosovë për të lehtësuar qasjen e QBMK “Xheladin Deda” në librat në formatin digjital.

Nga bashkëpunime tjera me SHVK nxënësit kanë marrë pjesë në kampimin e shoqatave të PAK në kampin në Banje të Pejës urse stafi i shkollës ka vizituar festivalin ballanik të këngëtarëve të verbër në Çanakkala të Turqisë, festivalin “Suhareka na bashkon” për këngëtarët e verbër

Në koordinimin me OJQ PEN për projektin tyre të të mësuarit mbi ambientin, nxënësit kanë marrë pjesë në aktivtete mjedisore që janë mbajtur në Rugovë dhe një nxënës i joni ka fituar një çmim për angazhimin. Nxënësit kanë marrë pjesë edhe në aktivtete avokuese për të drejtat e fëmijëve të verbër organizuar nga Forumi i aftësisë së kufizuar mbajtur në Pejë , në në orën letrare me personat e verbër ku është bërë prezantimi i nxënësve dhe ish nxënësve të shkollës si krijues letrar.

Një programin kulturor tre ditor, rehabilitues dhe argëtues me fëmijët me dëmtime është mbajtur nga partnerët tonë disa vjeçar organizata “Tumulus” France. Shkolla ka marë donacion me mjete dhe pajisje tiflo didaktike dhe për orientim nga OJQ You Can Do. Dhurata për vitin e Ri ka ofruar organzaita gjermane Arda Deutchland aksioni fëmijaj pret fëmijën



Në aktivitete tjera me nxënësit kanë marrë pjesë në aktivitete avokuese për të drejtat e fëmijëve të verbër organizuar nga Forumi i aftësisë së kufizuar mbajtur në Gjilan dhe Prishtinë, Konferenca “Zëri ynë” dhe në Kongresin botëror për personat me aftësi të kufizuara në Prishtinë. Gjatë javës së njeriut me shkop te bardhë sesionin ndërgjegjësuese janë mbajtur lidhur me shëndetin nga personeli shëndetësor në Qendrën burimore "Xheladin Deda" nga Suiss TPH, Syri i Vizionit dhe financim të (SDC), Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ndërsa organizuar nga Lions Club Istogu nxënësit kanë marrë pjesë në një ligjëratë lidhur me vendimmarrjen dhe zgjidhjen e projekteve bashkë me nxënës të shkollave tjera të Pejës.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal kemi mbajtur bashkëpunimin dhe jemi koordinuar me shkollat nga Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Bosnje Hercegovina, për projekte për përbashkëta lidhur me muzikën dhe rekreacionin për vitin 2023, për organizimin një konference të përbashkët në muajin shkurt, etj . Gjatë vitit shkollor janë realizuar dy vizita: Vizitë në shkollën Vinko Bek në Zagreb dhe në Shoqatën e të verbërve të Zagrebit bashkë me MASHTI dhe një tjetër vizitë në shkollën Dimitar Vllahov të Shkup në festën e tyre të shkollës

Është mbajtur komunikimi i vazhdueshëm për projektin me Ambasadën Japoneze për mundësinë e fillimit të implementimit të projektit, takime në Ambasadë dhe në MASHTI dhe projekti është ende në pritje.

Në shkollë kemi pritur delegacione dhe grupe të ndryshme që shprehin interesim për punën e shkollës. Kemi pasur vizita nga Vizitat nga Save the children, OJQ You can Do, Tumulus France, Doën Sindrom Kosova, nxënësve shkollave të komunës së Pejës, Shkollës së Artit dhe Shkollës së Muzikës nga Peja, drejtorit të zyrës për qeverisje të mirë në Qeverinë e Kosovës, Habit Hajredini, KFOR-i italian, etj kemi pasur poashtu një vizita nga shefit te EULEXit Lars-Gunnar Eëigemar më të cilin kemi zhvilluar një drekë punë në Rugovë . bazuar në bashkëpunimin dhe paraqitjen e nevojave i kemi parashtruar një kërkesë EULEXit, për dy vetura, për të cilën ende nuk kemi ëprgjigje. Dreke punë kemi pasur me ambasadorin çek në Kosovë Paven Bilek

Nga bashkëpunimi mi sportin me klubin e Xhudos në Pejë për pjesëmarrje në garat paralimpike me dy nxënës dhe një ish nxënës, pjesëmarrje e nxënësve në garat e Shahit Brezovica, nxënës dhe staf i angazhuar në pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare në kuadër të ekipeve kombëtares së Kosovës në shah në Itali dhe në futboll për personat e verbër në Austri.

Me komitetin paralimpik kemi përpuruar librin e gjithpërfshirjes në sport dhe jemi bashkërisht duke përgatitur programin tarjnimti të mësimdhënësve nëpër shkollat të Kosovës

### **Ngritja profesionale, shpërndarja e përvojës dhe krijimi i literaturës profesionale**

Përgatitja për publikimin e librit “Gjithpërfshirja në edukimin fizik” bashkëpunim me Komitetin paralimpik i Kosovës

Përgatitja dhe publikimi i Analizës: Personat e verbër në Kosovë, shkollimi dhe tregu i punës, realizimi i hulumtimit me telefonata

Prezantimi i hulumtimit mbi personat e verbër për ekipin e ligjit për të drejtat e autorit si dhe para grupit punues për hartimin e ligjit për gjithë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara

Prezantim para inspektorëve të punës për aftësimin dhe kualifikimet e personave të verbër

Incizimi i pjesëve audio nga libri “Psikologjia” për nxënësit e integruar

Shpërndarja e librave audio për nxënësit e integruar

Prezantim para shtëpive botuese të Kosovës në forumin “Rëndësia e Menaxhimit Kolektiv në fushën e të Drejtave të Autorit”, organizuar nga Zyra për të Drejtat e Autorit, detyrimet që dalin nga Trakti i Marakeshit në ligjin e ri për të drejtat e autorit, që është duke u hartuar në Kosovë për të lehtësuar qasjen e QBMK “Xheladin Deda” në librat në formatin digjital.

Në punëtorinë e organizuar nga Zyra e KE në Prishtinë dhe MASHTI, prezantim para zyrtarëve të DKA-ve për çështjet për bashkëpunimin e QB me DKA-të në shkollimin e FNVA

Paraqitja për konferencën shkencore ballkanike Beograd shkurt 2023

Incizimi i librit “Historia e sporti tek personat me aftësi të kufizuara në Kosovë”, MKRS

Incizimi i ngritjes së një kabinetit të IT sipas vendimit të MASHTI

Pjesëmarrje në panairin e Frankfurtit për teknologjinë informative për të verbër (koordinimi me bashkëpunëtorët)

Krijimi dhe regjistrimi i klubit sportiv të shkollës

Ofrimi i praktikës profesionale për 5 asistentë për FNVA dhe ndarja e përvojës sonë në vizitat nga grupet e asistentëve nga rajoni i Ferizajit dhe nga rajoni i Mitrovicës

Në paraqitjen në media kemi pasur dy Kronika në RTK, një reportazh nga federata e sporteve shkollë, një reportazh nga projekti ESAP 2 për aftësi profesionale dhe kronike nga RTK-Medika, disa kronika lidhur përurimin e librit Gjithpërfshirja në edukimin fizike, si në RTK, tv21, Ekonomia online, Koha.net, etj. po në këtë temë akoma qenë lajme në radio KFOR, intervista në studio ATV, TV21, RTK, Radio Kosova në tri data dhe emisione të ndryshme etj. Në tema dhe kohë tjera tri herë prezencë në Radio Peja në emisione në studio. Postime në rrjetet sociale dhe ueb faqet e disa ambasadave Kronika e zgjeruar kushtuar koncertit të Marigona Hamiti. Një reportazh i gjatë nga TV 1, shkollimi i personave të verbër, etj. artikuj në Lajmi.net, reportazhi nga revista For You, tri herë artikuj për aktivitetet e QB në revistën për personat e verbër “Syri ynë” .

Në rrjetet tona sociale gjatë vitit ka pasur rreth 100 postime për aktivitetet e QB.

# *Program i kandidaturës për kryetar të SHVK- Përgatitur për konkurrim në zgjedhjet e SHVK me datë 9 shtator 2023 në thirrjen për kandidim si kryetar*

Prishtinë, gusht 2023

Paraqitem me këtë program në thirrjen e SHVK për kryetar të shoqatës dhe shpreh angazhimin tim maksimal në rast së zgjidhem kryetar i Shoqatës së të verbërve të Kosovës. Gjatë mandatit tim do të angazhohem për fuqizimin e shoqatës dhe komunitetit të të verbërve, duke dhënë maksimumin tim si individ dhe bashkë me stafin e shoqatës, në mënyrë që me angazhimin tonë të përditshëm të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetës së komunitetit të personave të verbër në të gjitha fushat e jetës.

Angazhimi im si kryetar është i bazuar në dy qasje, përfundimin me sukses të projekteve dhe nismave aktuale për të cilat SHVK ka qenë e angazhuar në dy dekadat e kaluara dhe angazhimin për mundësi të reja bazuar në legjislacion vendor dhe ndërkombëtar që garanton mbrojtjen, përparimin dhe përmirësimin e statusit të personave të verbër në Kosovë dhe më gjerë.

Programi im është i bazuar në disa pika:

## **1. Implementimi i planit strategjik të SHVK 2019-2024**

- Me implementimin e këtij plani dhe përmbylljen me sukses të pjesës më të madhe të objektivave strategjike që ka shoqata
- Nga viti 2025 hartimi i planit të ri strategjik bazuar në nevoja

## **2. Fuqizimi i shoqatës së të verbërve të Kosovës**

- Angazhimi për një rol sa më aktiv dhe më të rëndësishëm të SHVK
- Garantimi i stafit ekzistues dhe stafi të ri profesional
- Krijimi i fondeve dhe mbështetjes për aktivitetet në komunitet
- Aplikimi në projekte te donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë
- Lobimi te Qeveria dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare për një status më të avancuar për Shoqatën e të verbërve në Kosovë
- Shtimi i anëtarësisë
- Përfshirja sa e madhe e anëtarëve në aktivitetet e shoqatës dhe në përgjithësi në aktivitetet sociale

## **3. Krijimi i partneriteteve që e fuqizojnë SHVK**

- Partneriteti me OJQ-të tjera në Kosovë, me theks të veçantë te OJQ e personave me aftësi të kufizuara
- Partneriteti me Qeverinë dhe institucionet shtetërore me krijimin të agjendave dhe

fushatave të përbashkëta në të mirë të komunitetit

- Partneriteti me organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare të angazhuara për të mbështetur fuqizimin e personave të verbër në Kosovë

#### **4. Avokimi dhe lobimi të qeveria dhe institucionet e shtetit të Kosovës**

- Avokimi lidhur me statusin e personave të verbër në Kosovë
- Përmirësimi i legjislacionit dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues
- Punësimi i personave të verbër
- Edukimi dhe krijimi i kushteve për edukim gjithëpërfshirës
- Siguria, shërbimet shëndetësore dhe mirëqenia e personave të verbër
- Angazhimi për lehtësimet tatimore dhe beneficione tjera që garanton ligji
- Financimi i projekteve dhe shërbimeve që ofron SHVK dhe financimi i përhershëm i shërbimeve për personat e verbër për të cilat SHVK është e licencuar nga shteti
- Rehabilitimi, etj.

#### **5. Përmbyllja e synimeve madhore që janë në proces**

- Përmbyllja e procesit aktual të hartimit të sintezës vokale
- Avokimi bashkë me aketëret tjerë për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës në mënyrë që në të të përfshihet Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- Angazhimi në krijimin e një qendre rehabilituese ashtu siç e parasheh ligji për personat e verbër

#### **6. Garantimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për personat e verbër**

- Angazhimi me MASHTI, Qendrën burimore dhe institucionet tjera arsimore për arsimin e të gjithë personave të verbër, garantimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës

#### **7. Zhvillimi i kulturës dhe krijimtarisë të personat e verbër**

- Angazhimi i shoqatës do të jetë zhvillimi i aktiviteteve kulturore, promovimi i vlerave dhe personave të suksesshëm në këto dy fusha, pjesëmarrja në gara dhe festivale, përfaqësimi sa më i mirë i komunitetet dhe vlerave

#### **8. Rrjetëzimi**

- Përfshirja e SHVK në rrjetë vendore dhe ndërkombëtare, krijimi i mundësive të reja dhe partneriteteve.

Varësisht nga nevojat e paraqitur gjatë mandatit tim, do angazhohem edhe në të gjitha çështjet që paraqiten si nevojë dhe si prioritete. Angazhimi im do të jetë aty ku e kërkon anëtarësia e

shoqatës, Shoqatat komunale dhe ndërkomunale në mënyrë që shoqata të jetë sa më efikase dhe mbrojtëse e mirë të drejtave të personave të verbër në Kosovë.

Në kryerjen e detyrave të mia do jem bashkëpunues me të gjithë aketërët brenda dhe jashtë shoqatës, duke përfshirë Kuvendin e Anëtarëve dhe kryesinë, stafin e punësuar, kryesitë dhe kryetarët e zgjedhura nëpër shoqata komunale dhe ndërkomunale, grupe tjera aktive dhe gjithë anëtarësisë sipas nevojës dhe kërkesave.

Pas konsolidimit të shoqatës në mandatin e kaluar, një angazhimi të vazhdueshëm pranë ministrive për zbatimin e legjislacionit dhe adresimin e çështjeve të pazgjedhur, pas krijimit të një bazë të gjerë dhe mbështetjes për SHVK, ky mandat mendoj se do ta çojë shoqatën në profesionalizim të mëtejshëm si një faktor që luan rol të rëndësishëm në shoqëri dhe që angazhohet ditë e natë për të plotësuar vizonin dhe misionin e saj.

Me respekt

Daut Tishuki, kandidat për kryetar